

## ÇKA DUHET TË PRES NGA KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI?

MË SË VONI NË AFAT PREJ 90 DITËSH NGA MOMENTI I PARAQITJES SË PARASHTRESËS, KOMISIONI DO TË MË DËRGOJ MUA, DHE ATIJ KUNDËR TË CILIT E PARASHTROJ PARASHTRESËN, MENDIM PËR DISKRIMINIMIN E PRETENDUAR DHE NËSE KONSTATON DISKRIMINIM, DO TA REKOMANDOJ MËNYRËN E EVITIMIT TË SHKELJES SË TË DREJTËS. KJO DO TË MË DËRGOHET MUA DHE ATIJ QË MË KA DISKRIMINUAR.

## ÇKA DUHET TË BËJË AI QË MË KA DISKRIMINUAR NËSE KOMISIONI KONSTATON DISKRIMINIM?

DUHET TA SHMANG SHKELJEN E TË DREJTËS NË AFAT PREJ 30 DITËSH NGA DITA E PRANIMIT TË REKOMANDIMIT DHE PËR KËTË TA NJOFTOJ KOMISIONIN.

## KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI

 Bulevardi "Dimitar Vllahov" (Ndërtesa e RTVM, kati 20)

 (02) 3232-242

 [contact@kzd.mk](mailto:contact@kzd.mk)

 [www.kzd.mk](http://www.kzd.mk)

FB: @AntidiscriminationMK

# BARAZI PËR TË GJITHË!

Shoqëritë demokratike, siç është shoqëria jonë, krijojnë një mori të institucioneve të cilat duhet t'i kënaqin nevojat e të gjithë qytetarëve. Në këtë kontekst, sundimi i së drejtës nënkupton ekzistimin e mekanizmave të fuqishëm të cilët na mundësojnë që rregullat e rendit të vlejné njësoj për të gjithë, pavarësisht dallimeve tona.

Komisioni për Mbrojtje nga Diskriminimi është një nga ato shtyllat institucionale të cilat pothuajse një dekadë, përpiqet me përkushtim që sa më shumë të jetë e mundur të mundësojë qasjen deri te drejtësia për viktimat nga diskriminimi në të gjitha segmentet e jetës shoqërore.

Në vazhdim, në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi nga viti 2010, janë prezantuar sqarime konkrete se si mund t'i mbronit të drejtat tuaja lidhur me diskriminimin dhe barazinë para këtij trupi të pavarur të ekspertëve.

## ÇKA ËSHTË DISKRIMINIMI?

DISKRIMINIMI ËSHTË ÇDO BËRJE E DALLIMIT OSE ÇDO VEPRIM I PABARABARTË, I DREJTPËRDREJTË OSE I TËRTHORTË, PËRKATËSISHT LËSHIM (PËRJASHTIM, KUFIZIM OSE DHËNIE TË PËRPARËSISË), I PAARSYESHËM NGA ASPEKTI JURIDIK OSE FAKTIK NË RAPORT ME PERSONA OSE GRUPE.

## NË ÇFARË BAZE MUND TË MË DISKRIMINOJ DIKUSH?

NË BAZË TË GJINISË, RACËS, NGJYRËS SË LËKURËS, GJINISË, PËRKATËSISË SË GRUPIT TË MARGJINALIZUAR, PËRKATËSISË ETNIKE, GJUHËS, SHETËSISË, ORIGJINËS SOCIALE, RELIGJIONIT APO MËSIMIT FETAR, ARSIMIT, PËRKATËSISË POLITIKE, STATUSIT PERSONAL OSE SHOQËROR, AFTËSISË SË KUFIZUAR MENDORE OSE TRUPORE, MOSHËS, GJENDJES FAMILJARE OSE MARTESORE, STATUSIT TË PRONËS, GJENDJES SHËNDETËSORE OSE MBI ÇFARËDO QOFTË BAZE TJETËR.

## SI MUND TË MË DISKRIMINOJNË?

### NË MËNYRË TË DREJTPËRDREJTË

QË KA PËR QËLLIM HEQJEN, PRISHJEN OSE KUFIZIMIN E NJOHJES OSE GËZIMIT TË BARABARTË TË TË DREJTAVE TË NJERIUT DHE LIRIVE THEMELORE, NË KRAHASIM ME TRAJTIMIN QË E KA OSE QË MUND TA KETË NJË PERSON TJETËR NË KUSHTE TË NJËJTA OSE TË NGJASHMË.

### NË MËNYRË TË TËRTHORTË

- KUR MUA OSE NDOJË GRUPI TË CILIT I PËRKAS, DO TË MË VËNË NË POZITË TË PAVOLITSHME NË KRAHASIM ME PERSONA TË TJERË OSE ME GRUPE TË PERSONAVE, DUKE MIRATUAR DISPOZITA DHE KRITERE DUKSHËM NEUTRALE OSE PËRMES NDËRMARRJES SË PRAKTIKAVE TË CAKTUARA.

- KUR MË SHQETËSOJNË OSE MË OFENDOJNË MUA OSE GRUPIN TË CILIT I PËRKAS, ME QËLLIM QË TË MË PËRÇMOJNË OSE TË KRIJOJNË NJË MJEDIS FRIKËSUES, PËRÇMUES OSE ARMIQËSOR.

- NËSE MUA, NË QOFTË SE JAM ME AFTËSI TË KUFIZUAR MENDORE OSE FIZIKE, ME QËLLIM DO TË MË PAMUNDËSOHET OSE DO TË MË VËSHTRËSOHET QASJA NË MBROJTJE SHËNDETËSORE, TRAJTIM MJEKËSOR DHE ILAÇE, NË VEGLA REHABILITIMI DHE MASA NË PËRPUTHJE ME NEVOJAT E MIA, SHKURTIMIN E TË DREJTËS SË MARTESËS DHE KRIJIMIT TË FAMILJES, SHKURTIMIN E TË DREJTËS SË ARSIMIT, TË DREJTËS SË PUNËS DHE TË DREJTAVE NGA MARRËDHËNIA E PUNËS, KUR NUK DO TË NDËRMERREN MASA PËR EVITIMIN E PENGESAVE NË QASJE, PËRKATËSISHT PËRSHTATJE TË INFRASTRUKTURËS DHE HAPËSIRËS, SHFRYTËZIMIT TË RESURSEVE TË DEDIKUARA PËR TË GJITHË OSE TË PJESËMARRJES NË JETËN PUBLIKE DHE SHOQËRORE.

- KUR MUND TË DËMTOHEM, SEPSE KAM DENONCUAR, KAM INICIUAR PROCEDURË OSE KAM DËSHMUAR PËR DISKRIMINIM.

## NË CILËN FUSHË MUND TË JEM I DISKRIMINUAR DHE TË KEM TË DREJTË TË PARAQES PARASHTRESË DERI TE KOMISIONI?

DERI TE KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI MUND TË PARAQES PARASHTRESË NËSE JAM DISKRIMINUAR NË CILËNDO QOFTË FUSHË, PËRKATËSISHT NË FUSHËN E PUNËS DHE MARRËDHËNIEVE TË PUNËS, ARSIMIT, SIGURISË SOCIALE, PËRFSHI EDHE SFERËN E MBROJTJES SOCIALE; SHËNDETËSISË, JURISPRUDENCËS DHE ADMINISTRATËS; BANIMIT; INFORMIMIT PUBLIK DHE MEDIATET; QASJES DERI TE TË MIRAT DHE SHËRBIMET; DHE NË FUSHA TË TJERA TË PËRCAKTUARA ME LIGJ.

## ÇKA DUHET TË BËJË NËSE DIKUSH MË DISKRIMINON?

TË PARAQES PARASHTRESË DERI TE KOMISIONI PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI MË SË VONI NË AFAT PREJ TRE MUAJSH NGA MOMENTI I DISKRIMINIMIT.

## SI TA PARAQES PARASHTRESËN?

ME SHKRIM OSE ME GOJË, PERSONALISHT NË KOMISIONIN PËR MBROJTJE NGA DISKRIMINIMI, PËRMES POSTËS, PËRMES TELEFONIT, PËRMES POSTËS ELEKTRONIKE OSE PËRMES FORMËS ELEKTRONIKE NË FAQEN E INTERNETIT TË KOMISIONIT. NUK PAGUHEN KURRFARË TAKSASH OSE KOMPENSIME PËR PARAQITJEN E PARASHTRESËS.

## NË CILËN GJUHË TA PARAQES PARASHTRESËN?

- NË GJUHËN MAQEDONASE;
- NË GJUHËN TË CILËN E FLASIN MË SHUMË SE 20% E QYTETARËVE;
- NËSE JETOJ NË NJËSINË E VETËQEVERISJES LOKALE, NË TË CILËN MË SË PAKU 20% E QYTETARËVE FLASIN GJUHË ZYRTARE TË NDRYSHME NGA GJUHA MAQEDONASE, MUND TA PËRDOR CILËNDO QOFTË NGA GJUHËT ZYRTARE DHE ALFABETIN E SAJ TË CILAT JANË NË PËRDORIM NË NJËSITË E VETËQEVERISJES LOKALE, NDËRSA KOMISIONI DO TË MË PËRGJIGJET PËRVEÇ NË GJUHËN MAQEDONASE EDHE NË ATË GJUHË.

## ÇKA DUHET T'I BASHKËNGJIS PARASHTRESËS?

TË GJITHA FAKTET DHE PROVAT QË MENDOJ SE JANË NË FAVOR TË KONFIRMIMIT TË DISKRIMINIMIT.